



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-11536/21 datë: 26.05.2021



Npi – 01/158 datë: 01.06.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 01.06.2021 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 01.06.2021 (e martë) në ora 11.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit
Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe:

Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 16.04.2021,
2. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale në Ngastren Kadastrale Nr.333-4, S= 21986 m², në Zonën Kadastrale-Davidovc, (Rekomandimi i Komisionit Vlerësues)
3. Raporti tremujor Buxhetor Janar-Mars 2021,
4. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024,
5. Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha, sipas rekomandimit të MPL-së,
6. Draft-Statuti i ri i QKMF-së “Vezir Bajrami” në Shitime, (Pas diskutimit publik)
7. Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht, (Pas diskutimit publik)
8. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së “Adem Jasharit”, (pas diskutimit publik)

Procesverbali Npi-01/158 i datës 01.06.2021

Me kërkesën e Kryesueses së Kuvendit znj.Medina Brahaj, diskutimi për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 01.06.2021, anëtarëve të KPF-së u është dërguar në formë elektronike në CD-Disc, dhe në formë të tillë e kanë miratuar.

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 21.09.2021, me shumicën e votave miratoi procesverbalet në formë elektronike (CD-Disc) të datave: 01.03.2021, 26.03.2021, 01.06.2021, 22.06.2021, 09.07.2021 dhe 24.08.2021.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj